

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”

Programi i lëndës “Gjuha e huaj”

SHKALLA E TRETË



QERSHOR 2014

1. Hyrje

Gjuha e huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, etj.) bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar, i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tyre personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Mësimi i gjuhës shqipe dhe i gjuhëve të huaja i ndihmon nxënësit që të bëhen individë të pavarur, të lirë, të kulturuar, mendimtarë kritikë dhe krijues, njerëz të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore (në gjuhën shqipe ose gjuhë të huaj), nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhët, kulturën kombëtare dhe botërore.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën, kuriozitetin dhe besimin e nxënësve për të bërë një komunikues të mirë, lexues aktiv e të pavarur dhe shkruar të saktë, origjinal dhe krijues. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë, janë një nga detyrat parësore të arsimit, të cilat synojnë të përmbushin pesë kompetencat: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit dhe përdorimi i drejtë i gjuhës.


Kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Gjuhë e huaj e parë, Gjuhë e huaj e dytë.

Gjuha shqipe mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës, nga klasa përgatitore deri në klasën XII.

Gjuha e huaj e parë fillon në shkallën e dytë (klasa III) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa VI) dhe vazhdon deri në shkallën e gjashtë (klasa XII). Si gjuhë e huaj e dytë mund të jetë: gjuha frënge, gjuha italiane, gjuha gjermane etj.

I. Korniza konceptuale e programit



II. Qëllimet e programit të lëndës «Gjuha e huaj»

Qëllimet e lëndës së gjuhës së huaj në arsimin bazë janë:

- Zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues.
- Përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë nxënësit.
- Gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi i informacioneve


Programi mësimor i gjuhës së huaj për klasat 6-7 është hartuar në përputhje me Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar, si dhe në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Lënda e gjuhës së huaj ka për mision aftësimin dhe orientimin e nxënësve për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi në këtë gjuhë. Ajo ka detyrë të zhvillojë te nxënësit aftësitë e gjuhës gjatë përdorimit të saj dhe t'i edukojë ata me të kuptuarit, pranimin dhe vlerësimin e kulturës dhe mënyrës së jetesës së popujve të tjerë. Nxënësit gjithashtu mësojnë dhe binden që gjuha e huaj, si një subjekt aftësish dhe mjet komunikimi, kërkon kohë dhe praktika të shumëllojshme komunikimi për t'u përvetësuar. Si lëndë akademike, gjuha e huaj është një lëndë kulture dhe aftësish.

Mësimi i gjuhës së huaj në klasën e gjashtë të arsimit nëntëvjeçar zhvillohet në nivelin A2.1 duke iu referuar *Kuadrin të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët*, duke vazhduar në klasën e shtatë me nivelin A2.1.2 (përdorues elementar)

Nxënësi në fund të këtij niveli mund të kuptojë fjali të shkëputura dhe shprehje të përdorura shpesh në lidhje me fusha që kanë përparësi imediate, (si informacione personale ose familjare të thjeshta, blerje, mjedisi më i afërt, etj.) mund të komunikojë gjatë kryerjes së detyrave

të thjeshta, të zakonshme që kërkojnë një shkëmbim të thjeshtë informacionesh të thjeshta e të drejtpërdrejta , mbi tema të njohura dhe të zakonshme.



Interesat dhe tematikat në këtë program do të jenë të ndryshme, pasi shkalla e ndërgjegjësimit të nxënësit për domosdoshmërinë e mësimit të gjuhës së huaj është më e lartë dhe mësimi i gjuhëve të huaja lidhet me problemet e formimit e të ardhmes së tij si qytetar evropian. Zotërimi i mirë i gjuhës së huaj ndihmon në zgjerimin e dijeve në fusha të tjera. Përvetësimi i gjuhës së huaj kontribuon jo vetëm në pasurimin dhe në lulëzimin e individualitetit të nxënësit, por edhe në ndërtimin e qëndrimeve dhe të sjelljeve etike që i shërbejnë komunitetit dhe krijimit të një qytetari të ri evropian.

III. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës / lëndës




Tabela: Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj gjatë shkollës të dytë.

Shkalla 3

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

- Shpreh përjetimet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit dhe dëgjimit të një filmi, dokumentari, ekspozite, dramatizimi, recitimi, etj. në njërin nga format shprehëse (me gojë, me shkrim, vizatim, mimikë, lëvizje etj).
- Dëgjon me vëmendje prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim me fjali të thjeshta, mbi tema të njohura, me kusht që bashkëfolësi të jetë i gatshëm të përsërisë apo riformulojë frazat e tij.
- Lexon saktë me zë një tekst të shkurtër me fjalë të njohura dhe tematikë nga jeta e përditshme.
- Shkruan një tekst të shkurtër e të thjeshtë për një temë të njohur.
- Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge, etj., dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
- Shpreh me gojë dhe me shkrim fjali të thjeshta në gjuhën e huaj dhe i përkthen në gjuhën amtare.
- Shkruan një kartolinë të shkurtër e të thjeshtë, një urim, plotëson një pyetësor me detaje personale.

Kompetenca e të menduarit

- Sqaron me anë të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore.
- Identifikon për një temë/ngjarje, personazhet, kohën, vendin, etj.
- Shprehet pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

Kompetenca e të nxënit

- Ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim / aktivitet / detyrë, që kërkohet .
- Pyet dhe përgjigjet lidhur me tematika nga jeta e përditshme, me një fjalor të thjeshtë.
- Zgjidh në mënyrë të pavarur, por edhe me ndihmën e mësuesit problemin, detyrën e dhënë duke e prezantuar para të tjerëve.
- Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal.
- Shfrytëzon burime të ndryshme informacioni për përgatitjen e një teme të dhënë.
- Identifikon dhe krahason informacionet e njohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar nga jeta e përditshme duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh duke i shënuar me shenja të ndryshme).
- Krahason përparimin e tij, me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një veprimtarie të caktuar.
- Përdor portofolin personal si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara, duke hartuar një plan pune me hapa konkrete për përmirësim.
- Prezanton për 3 minuta veten, shkollën, familjen, dëshirat, etj., me fjali të thjeshta.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

- Përgatit një plan të thjeshtë ditor me shkrim, për dy- tri aktivitete ditore, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrës.
- Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup.
- Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet,..etj) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi.
- Përgatit një autobiografi ku prezanton veten, të dhënat personale dhe prirjet, që ka për fusha të caktuara, si dhe profesionin e

dëshiruar.

- Përgatit një plan pune një javor.
- Diskuton me një fjalor të thjeshtë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë, në shkollë dhe mjedise të tjera në një situatë të caktuar, duke prezantuar idetë nëpërmjet shembujve konkretë.

Kompetenca personale

- Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj.
- Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët. (projekti/ aktiviteti në bazë klase /shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca qytetare

- Përcakton rregullat e punës në grup, në bashkëpunim me anëtarët e grupit.
- Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët, për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
- Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

Kompetenca digjitale

- Identifikon personazhet, kohën, vendin e një teksti të shkurtër të dëgjuar (nga mjetet audio-vizuale), të shprehur qartë dhe ngadalë.
- Realizon punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur

emocionet e tyre.

- Përdor teknologjinë digjitale për të gjetur informacionin e nevojshëm.

IV. Lidhja e gjuhës së huaj me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënit, të cilat ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë, me jetën dhe interesat e tyre. Në Kornizën kurrikulare dhe në kurrikulat bërthamë janë përcaktuar temat ndërkurrikulare, të cilat janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.


Gjuha e huaj zhvillon te nxënësit njohjen e vlerësimin e kulturës botërore dhe kultivon identitetin dhe krenarinë kombëtare. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj. mund të realizohen gjatë orëve mësimore të kompetencës së të folurit. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore gjatë të cilave nxënësit shprehen në forma të ndryshme: ese,

poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë çështjet e mësipërme. Punët në grupe dhe projektet që zhvillohen në lëndën e gjuhës së huaj, ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

V. Lidhja e gjuhës së huaj me fushat e tjera kurrikulare

Gjuha e huaj i pajis nxënësit me njohuri, aftësi dhe shkathtësitë që sigurojnë suksesin e nxënësve edhe në fushat dhe lëndët të tjera. Kjo lëndë u mundëson atyre që të kuptojnë tekste ose mesazhe të ndryshme, të komunikojnë me të tjerët në mënyrë korrekte.

Më konkretisht, këto njohuri dhe aftësi janë dhënë në tabelën e mëposhtme:



VI. Ndarja e orëve mësimore për secilën klasë

Gjuha e huaj është lëndë e detyrueshme në arsimin bazë. Ajo zhvillohet nga klasa e tretë deri në klasën e nëntë të këtij arsimit. Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për shkallën e tretë (klasa 6-7), sipas orëve vjetore të përcaktuara në Planin Mësimor të Arsimit Bazë.

Orët Mësimore 35 javë x 3 orë = 105 orë vjetore

Programi i gjuhës angleze për arsimin bazë, përcakton raportin: Komunikim, Formim kulturor dhe Formimi gjuhësor.

Kjo krijon mundësi për formimin e aftësive dhe shprehive afatgjatë tek nxënësit.

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në kapituj e njësi mësimore) objektivat sipas kompetencave të përshkruara më lart ndërthuren me njëra-tjetrën dhe mund të zënë vend aty ku përdoruesi e sheh më të arsyeshme për t'i zbatuar. Konceptimi i kapitujve të tekstit dhe njësive mësimore është e drejtë dhe detyrë e autorit të tekstit dhe mësuesit. E rëndësishme është në këtë rast, që zbatuesit e programit të jenë të vëmendshëm në realizimin cilësor të të gjitha objektivave të përcaktuara në këtë program.

SHKALLA E TRETË	Komunikim dhe formim kulturor	Formimi gjuhësor	Orë/vit
Klasa e gjashtë	70 orë	35 orë	105 orë
Klasa e shtatë	70 orë	35 orë	105 orë
Total	105 orë	105 orë	210 orë

Shkalla 3 (Klasa 6 dhe Klasa 7)

Kompetenca: Të dëgjuarit

Përshkrimi i kompetencës Nxënësi mund të kuptojë shprehje dhe një fjalor shumë të përdorshëm që lidhet me atë që i përket (veten, familjen, blerjet, mjedisin e afërt). Mund të kapë thelbin e lajmërimeve, të mesazheve të thjeshta dhe të qarta.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të dëgjuarit Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• Tregon se kupton pikat kryesore dhe mendimet të shprehura në pasazhe të përbëra nga materiale të njohura nga kontekste të ndryshme, duke përfshirë ngjarje të ditës apo të ardhme.• Ata mund të kenë nevojë për disa përsëritje.	
Njohuritë për realizimin e kompetencës	Aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e kompetencës
<i>Njohuritë për klasën e gjashtë</i> <ul style="list-style-type: none">• <i>Shprehje dhe një fjalor të përdorshëm që lidhet me shijet, preferencat, mjedisin, kohën, hobet, etj. (veten, familjen, blerjet, mjedisin e afërt)</i>• <i>Emri, adresa, mosha, etj.</i>• <i>Aktivitetet në kohën e lirë dhe preferencat e tij.</i>• <i>Udhëzime të thjeshta për të shkuar nga</i>	Të dëgjuarit Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• dëgjon dhe reagon ndaj fjalive të thjeshta, të artikuluar ngadalë dhe me gjuhë të qartë;• identifikon objekte të ndryshme, kur ato dëgjohe, përmenden apo tregohen;• reagon përmes veprimtarive fizike ndaj orientimeve, udhëzimeve dhe veprimeve të mësuesit apo të njerëzve që e rrethojnë;• reagon kur dëgjon modele të caktuara që shprehin ndjenja, aprovim apo

<p><i>një vend në tjetrin, në këmbë ose me mjete të transportit publik.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Shifra, numra telefoni, çmime.</i> 	<p>refuzim;</p> <ul style="list-style-type: none"> • kuptojnë fraza, fjali dhe shprehje që lidhen me fushat e interesit të tyre, informacione për veten, familjen shokët, vendbanimin, klasën, shkollën; • Kupton dhe komenton fakte të ndryshme;
<p>Njohuritë për klasën e shtatë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fjali të thjeshta mbi vendndodhjen. • Histori të thjeshta, ngjarje të thjeshta në kohën e tashme, të shkuar apo të ardhme. • Pjesë të incizuara, me kusht që folësi të jete i qartë dhe me ritëm të ngadaltë. • Përshkrimi i një personi/sendit. • Numrat deri në njëmijë. • Kuptimi i mesazheve në ambiente të ndryshme publike, si aeroport, supermarket, stacion treni, etj. 	
<p>Të dëgjuarit</p> <p>Studime tekstesh të tilla si: dialogë të shkurtër, dramatizime të ndryshme, përralla, shfaqje për fëmijë, rregulla praktike etj.</p>	

Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës

Nxënësi:

Shfaq sjellje të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si p.sh: ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon; nuk e ndërpret tjetrin, kur është duke folur; e sheh në sy personin gjatë kohës që flet; shpreh pëlqim dhe interes ndaj asaj që dëgjon, duke reaguar

Kompetenca: Të folurit

Përshkrimi i kompetencës

- Nxënësi mund të komunikojë gjatë kryerjes së detyrave të thjeshta dhe të zakonshme, të cilat kërkojnë një shkëmbim informacioni të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë mbi tema dhe veprimtari të njohura. Përshkruan me terma të thjeshta familjen, njerëzit e tjerë, kushtet e jetesës, ambientin.

Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të folurit

Nxënësi:

- Shprehet nëse është dakord apo jo, kur i kërkohet mendim për një çështje të njohura;
- flet kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën ose kur përshkruan diçka etj;
- diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta;
- përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve dhe ekspozitave në klasë;
- merr pjesë në lojë me role;

Njohuritë për realizimin e kompetencës	Aftësitë dhe shkathtësitë për realizimin e kompetencës
<p>Njohuritë për klasën e gjashtë</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Prezantim i vetes dhe shokut.</i> • <i>Përshkrimi i vetvetes, ambientit familjar, shijet.</i> • <i>Përshkrim i një ngjarjeje.</i> • <i>Dhënia e një opinioni pozitiv ose negativ.</i> • <i>Komentimi i disa fakteve.</i> • <i>Projekte personale.</i> • <i>Vendosja në kohë dhe hapësirë, etj.</i> 	<p>Të folurit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan kohën e lirë. • Tregon se çfarë ka bërë gjatë një fundjave. • Vlerëson, krahason, objekte dhe persona. • Bën projekte personale. • Bën zgjedhje dhe justifikon zgjedhjet e tij. <p>Të folurit ndërveprues</p>
<p>Njohuritë për klasën e shtatë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ritregimi i një ngjarjeje në kohën e shkuar dhe të ardhme. • Nevojat dhe domosdoshmëritë. • Dhënie dhe kërkim i një informacioni të nevojshëm. • Shpjegimi i funksionit të një objekti. • Njohuri rreth artit kulinar. • Veshjet dhe stili i të veshurit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Merr dhe jep këshilla mbi aspekte të jetës së përditshme si këshilla për të kaluar fundjavën, pushimet verore. • Flet për familjen, miqtë në një diskutim me miqtë e tij. • Bën dhe pranon një ftesë. • Diskuton dhe sugjeron programin e një mbrëmjeje. • Diskuton për një eveniment kulturor. • pyet dhe kërkon sende që i nevojiten për të kryer një punë; • pyet dhe u përgjigjet pyetjeve për veten, familjen, shkollën dhe vendbanimin;

<ul style="list-style-type: none"> • Punët e shtëpisë. • Shtetet dhe klima. • Numrat deri në një milion. 	<ul style="list-style-type: none"> • pyet dhe shpjegon funksionin e një objekti • përdor fjali të thjeshta për të shprehur ndjenja, dëshira, për të dhënë informacione dhe për të bërë përshkrime • Vlerëson, krahason dhe karakterizon dikë ose diçka.
Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës	
<p>Nxënësi:</p> <p>përzgjedh fjalorit e duhur gjatë të folurit (nuk fyen të tjerët, përdor fjalët dhe shprehjet e mirësjelljes).</p>	

Kompetenca: Të lexuarit

<p>Përshkrimi i kompetencës</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Nxënësi mund të lexojë tekste të thjeshta dhe të shkurtra. Mund të gjejë një informacion të veçantë të parashikueshëm në dokumente të përditshme, si reklama, fletëpalosje, meny ose orare dhe mund të kuptojë letra dhe mesazhe personale, të shkurtra dhe të thjeshta.
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të lexuarit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor strategjitë e duhura për të lexuar tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë dhe paragrafin;

<ul style="list-style-type: none"> • lexon me zë një tekst të shkurtër dhe identifikon personazhet, vendndodhjen dhe kohën e ngjarjes; • ritregon ngjarjen në mënyrë koherente; • jep përshtypjet e veta në lidhje me një tekst të shkurtër letrar dhe joletrar. 	
Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës	
Njohuritë	Aftësitë dhe shkathtësitë
<p><i>Njohuritë për klasën e gjashtë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>dallimi i tabelave në vende publike, si rrugë, stacion, shkollë, supermarket, etj.</i> • <i>dallimi i të dhënave personale, emër, adresë, ditëlindje, në një formular ose pyetësor të thjeshtë;</i> • <i>kuptimi i një mesazhi të thjeshtë ose një ftese apo kartoline;</i> • <i>kuptimi i të dhënave kryesore në një meny, njoftim, orar, një faqe interneti, etj.</i> 	<p>Të lexuarit fillestar</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lexon dhe kupton tabelat në vende publike. • Lexon tekste që përmbajnë fjalë dhe fraza me fjalor të njohur nga fondi bazë i gjuhës së huaj. • Kupton një mesazh të thjeshtë, si sms, e-mail, etj. <p>Të lexuarit për të kuptuar tekstin</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së një • teksti, ose rreth fjalëve të panjohura për të (Ku? Kur? Pse? Si ndodh kjo? Çfarë • do të thotë?); • rilexon tekstin për të kuptuar më mirë atë (kur është e nevojshme);
<p>Njohuritë për klasën e shtatë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kuptimi i mënyrës së përdorimit 	

<p>(udhëzuesi) të një aparati të thjeshtë, si aparat fotografik, magnetofon, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohuri të thjeshta për artin kulinar. • Kuptimi i pikave kryesore në një tregim me temë familjare ose shoqërore. • Kuptimi i një rubrike të veçantë në një gazetë ose dokument, si informacion kulturor, sportiv, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • dallon të dhëna personale në një pyetësor; • identifikon mesazhe, komente të thjeshta mbi detyrat dhe punën e bërë; • lexon dhe kupton tekste të thjeshta me gjuhë jo shumë të ngarkuar. (me ndihmën e fjalorit) <p>Të lexuarit e teksteve letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lexon vjersha, përralla, tregime të shkurtra, etj; • përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe jep mendimin e tij; <p>Të lexuarit e teksteve joletrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekste joletrare si: udhëzime, kartolina, reklama, etj.; • dallon pjesët përbërëse të një tregimi, hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen;
<p>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mban trupin në një qëndrim të përshtatshëm dhe librin në pozicionin e duhur gjatë kohës që lexon; • lexon me interes, emocion, dëshirë dhe me ndjenjë. 	

Kompetenca: Të shkruarit

Përshkrimi i kompetencës ● Nxënësi mund të mbajë shënime dhe shkruan mesazhe të thjeshta dhe të shkurtra, mund të shkruajë një letër personale falënderimi, të shkurtër dhe të thjeshtë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencën e të shkruarit Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• shkruan në një letër atë që i ka ndodhur në një të shkuar të afërt ose të largët;• shkruan tekste të thjeshta për të bërë një ftesë ose propozim. (letër, kartolinë) sipas modeleve të dhëna.	
Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës	
Njohuritë	Aftësitë dhe shkathtësitë

Njohuritë për klasën e gjashtë

- *Shkrimi i një mesazhi ose letre të thjeshtë duke përdorur formula mirësjelljeje.*
- *Përshkrimi në një letër personale i familjes, vendit ku banon, kohës dhe me se merret.*
- *Përshkrimi i shtëpisë, punët shtëpiake dhe mobilimi.*
- *Përshkrimi i artikujve ushqimorë, i një recete kuzhine, shijeve, preferencave, etj.*
- *Përshkrimi i një personi duke dhënë detaje për veshjen, karakterin, etj.*
- *Përshkruan itinerarin e një udhëtimi.*

Nxënësi:

- Përshkruan në një letër personale familjen, vendin ku banon, kohën dhe me se merret.
- Përshkruan një person duke dhënë detaje për veshjen, karakterin, etj.
- Përshkruan itinerarin e një udhëtimi.
- Shkruan një recetë kuzhine.

Të shkruarit si produkt

Nxënësi:

Njohuritë për klasën e shtatë

- Përshkruan thjeshtë njerëzit, vendin, studimet e tij.
- Përshkruan thjeshtë atë që dëshiron të bëjë në një të ardhme të afërt.
- Përshkruan thjeshtë atë që i ka ndodhur në një të shkuar të largët ose të afërt.

- Përshkruan kujtimet e fëmijërisë;
- përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të;
- rrëfen histori e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet: *Kush? Cili? Çfarë? Si? Kur? Ku?* etj.;
- jep përshtypjet e një udhëtimi;
- shkruan tekste të shkurtra si: një urim, një kartolinë, një letër drejtuar një shoku;
- harton një plan të thjeshtë të regjimit ditor;
- redakton një kritikë pozitive ose negative mbi një libër, film, ngjarje, etj.

Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës

Nxënësi:

Mban gjatë të shkruarit pozicionin e duhur të trupit, dorës, fletores ose fletës ku shkruan.

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës

Përshkrimi i kompetencës

- Nxënësi në fund të këtij niveli mund të kuptojë fjali të shkëputura dhe shprehje të përdorura shpesh në lidhje me fusha që kanë përparësi imediate, (si informacione personale ose familjare të thjeshta, blerje, mjedisi më i afërt, etj.) mund të komunikojë gjatë kryerjes së detyrave të thjeshta, të zakonshme që kërkojnë një shkëmbim të thjeshtë informacionesh të thjeshta e të drejtpërdrejta, mbi tema të njohura dhe të zakonshme.

Rezultatet e të nxënit për kompetencën e përdorimit të drejtë të gjuhës

Nxënësi:

- Dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore, pyetëse, në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme.
- Zgjedhon folje të rregullta dhe të parregullta, në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme, sipas modeleve të dhëna.
- Përdor përemrat lidhorë.

<ul style="list-style-type: none"> • Përdor mbiemrat cilësorë, pronorë, dëftorë, etj. 	
Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	
Njohuritë	Aftësitë dhe shkathtësitë
<p><i>Njohuritë për klasën e gjashtë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Zgjedhimi i foljeve të rregullta e të parregullta në kohë të thjeshta e të përbëra, në mënyrën dëftore.</i> • <i>Riprodhimi i formave të gatshme gjuhësore</i> • <i>Numërorët themelorë dhe rreshtorë.</i> • <i>Emrat e numërueshëm e të panumërueshëm.</i> • <i>Shkallët e krahasimit të mbiemrave.</i> • <i>Ndajfoljet dhe formimi i tyre.</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor numrat dhe shifrat në situata të ndryshme. • Përdor në fjali emrat e numërueshëm e të panumërueshëm • Përdor në përshkrime kohën e pakryer. • Dallon emrat e numërueshëm e të panumërueshëm, duke vendosur njëjën përkatëse. • Përdor lidhëzat më të rëndësishme për të treguar rendin kronologjik të ngjarjeve. • Përdorimi i mënyrës kushtore si formulë politese. • Përdor në fjali dhe situata të caktuara ndajfoljet e mënyrës,

<p>Njohuritë për klasën e shtatë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohuri fillestare për kohën e pakryer të foljeve. • Dallimi i pjesëve kryesore të ligjëratës. • Përdorimi i parafjalëve dhe lidhëzave më të rëndësishme për të treguar rendin kronologjik të ngjarjeve. • Zgjedhimi dhe përdorimi foljeve të rregullta e të parregullta në kohët e tashme, të shkuar dhe të ardhme. • Ndajfoljet e mënyrës, sasisë, vendit, kohës, etj. • Njohuri fillestare për mënyrën kushtore. 	<p>sasisë, kohës, vendit, etj.</p>
<p>Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • paraqet dhe komunikon me gjuhë të thjeshtë mendimet e tij; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet personale dhe ato në grup. 	

VII. Udhëzime metodologjike

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre do të shërbejë për zhvillimin gjuhësor të nxënësve.

Mësuesit duhet të përditësojnë çdo ditë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësit dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm dhe aktivë në jetën e përditshme. Metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: *diskutim për njohuritë paraprake, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditarët e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen* etj. shërbejnë si nxitje për nxënësit në procesin e të nxënësve dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e të nxënësve. Mësimdhënia e gjuhës së huaj duhet të karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

Mësimdhënie me nxënësin në qendër

Nxënësit do të jenë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces do të ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për arsye të ndryshme se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lënda e gjuhëve të huaja kërkon që nxënësit të nxënë konceptet, të zotërojnë shprehjet dhe të zbatojnë njohuritë gjuhësore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve. Qëllimi i çdo strategjie të mësimdhënies është që çdo nxënës të mësojë dhe të zbatojë njohuritë gjuhësore në mënyrë efektive.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit do të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata do të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarit bashkëveprues. Nxënësit gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh do të nxiten të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta do t'u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur dhe për të ndarë përvojat e tyre me njëri-tjetrin. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe do të nxisë tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe do të ndikojë në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

Integrimi

Linjat e programit: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe njohuri rreth sistemit gjuhësor do të trajtohen në mënyrë të integruar që të sigurohen lidhje kuptimplota mes tyre. Asnjëherë nuk mund të bëhen veprimtari vetëm për njërin nga linjat e programit. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe zhvillohen së bashku. Një lidhje e fortë ndërmjet këtyre linjave forcon cilësinë e të nxënësve.

Procesi i rimarrjes së njohurive

Aftësitë, njohuritë rreth sistemit gjuhësor, llojet e ndryshme të teksteve do të zhvillohen duke u rishikuar dhe rishqyrtuar vit pas viti, por në një nivel më të lartë vështirësie. Kjo do t'u mundësojë nxënësve të përparojnë nga niveli bazë në nivele më të larta të përdorimit të gjuhës.

VIII. Udhëzime për vlerësimin

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënësve. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e objektivave të programit për secilën klasë, si dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, përcaktimin e kohës së përshtatshme për vlerësim dhe përzgjedhjen e materialeve që do të vlerësohen duhet pasur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së objektivave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- besimi se të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet;

Vlerësimi i nxënësve ndahet në tre tipa kryesorë:

Vlerësimi diagnostikues që zakonisht kryhet në fillim të vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies së mësuesit dhe të nxënësve në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

Vlerësimi formues është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënësve. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësve.

Vlerësimi përmbljedhës kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar mbas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbljedhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Gjatë zbatimit të programit nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup, për kryerjen e detyrave, të cilat mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënës, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimi dhe të vendosë nota në regjistër për secilën prej tyre. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirë kryerjes së detyrave jashtë klase.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim. Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me gojë, në testimet periodike me shkrim dhe në punët me shkrim, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon teste periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimi, të cilat i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësve. Një formë e vlerësimit me shkrim nga nxënësit janë edhe testimet semestrale dhe përfundimtare, të cilat nuk janë domosdoshmërisht të detyrueshme.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, si: qortimet nga mësuesi. Praktikrat e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri tek rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve; ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndërlëndore etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësi, mësuesi rekomandon.

Pjesë e vlerësimit është edhe informimi i nxënësve dhe prindërve për rezultatet e vlerësimit. Informacioni është përshkrues ose me notë. Detaje që kanë lidhje me vlerësimin në arsimin bazë gjenden në dokumente zyrtare të posaçme për këtë.